



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:086740

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06527520

C.nr.547/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. H., numër personal ... nga P., të cilën e përfaqëson av. F. G. avokat nga P., Rr: “F. A.”, HY-..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e P., Drejtoria Komunale e Arsimit nga P., Rruga “N. G.” pn., me objekt kontesti, kompensimin e 70 % të shpenzimeve të udhëtimit, me vlerë të kontestit: **173.60 €**, jashtë seance me dt.29.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
- pa shqyrtim kryesor të çështjes -

I. APROVOHET tërësisht kërkesëpadia e paditëses B. H., nga P., **si e bazuar**, dhe:

II. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B. H., t’ia kompensojë në emër të shpenzimeve të rrugës-udhëtimit 70% të biletës (për periudhën kohore 21.01.2021 e deri më 21.11.2022), për 248 ditë të pranisë në punë, nga 1.00 € (biletë udhëtimi ne ditë) x 70 % shumën prej 173.60 €uro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 98.00 eurove, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

III. Refuzohet kërkesa e paditëses që kamata ne shumen e llogaritur të jetë nga data e paraqitjes të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësja B. H., me datën 18.03.2024 përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ashtu që ka kërkuar shumën e përgjithshme prej 173.60 €uro €uro.

Ka shtuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura ku punon si punëtor arsimit në SHFMU “K. K.” në P.. Ka theksuar se duke u bazuar në Ligjin e Punës nenin 90 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës përkatësisht nenin 35 paragrafi i 5 paditësit asnjëherë nuk i është bere pagesa ne emër te kompensimit te udhëtimit dhe asnjëherë nuk është zbatuar kontrata kolektive.

Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë pagesën e shpenzimeve të udhëtimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi te datës 26.11.2024, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për pagesën e shpenzimeve të transportit. Ka shtuar se paditësi fillimisht është dashur që këtë çështje ta inicioi në procedurë administrative, duke ju drejtuar të paditurës. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 46 të saj është paraparë se: MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 dhe paragrafët e këtij neni andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Po ashtu kjo kontrate kolektive sipas nenit 90.5 të LP – së vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në kontratën kolektive.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, komform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 35 par.5 është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.”* por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi konform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.5 dhe 7 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Kontratën e Punës të paditësit me nr. Protokolli ... e datës 01.09.2018, Vërtetimin Nr. Protokolli ... i datës 16.03.2023 mbi ditët e pranisë në punë të paditësit, lëshuar nga SHFMU “K. K.” në P., Vërtetim mbi

udhëtimin i lëshuar nga Kompania Private e Udhëtimit N.T. “L. T.” – P., si provë, me ç ‘rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.5 të saj.

Andaj, në lidhje me kompensimin e 70 % të shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e aprovoi kërkesëpadinë për 248 ditë, përkatësisht shumë prej 173.60 Euro, si të bazuar, duke e llogaritur si në vijim: $248 \text{ (ditët në punë)} * 1.00 \text{ € (shpenzimet në euro e biletës së udhëtimit për një ditë)} * 70\% = 173.60 \text{ €}$, kjo duke u bazuar në kontratën kolektive ku përcaktohet se 70% i shpenzimeve të udhëtimit duhet të ju paguhen punonjësve të arsimit.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e të paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa të shpenzimeve të udhëtimit dhe shujtave të ushqimit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 78.00 euro, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20.00 eurove gjithsejtë shumen 98.00 €, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.547/24, me datën 29.11.2024**

Gjyqtari:
Binak Duqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.